

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR
VLORË

Nr. 1892 Rregj.Themeltar

VENDIM

“Për pranimin e kërkesës për sigurimin e padisë”

Gjkata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, e përbërë nga:

ĜJYQTARE - ELONA MIHALI

Asistuar nga sekretare gjyqësore Rezarta Lazaj, sot më 04.06.2015 në seancë prebatore, mori në shqyrtim kërkesën e palës paditëse për sigurimin e padisë që i përket çështjes civile me Nr. 1892 Rregj.Themeltar me palë ndërgjyqëse:

Paditës:

Mantho Bua, i biri i Spiro dhe Athina, datëlindje 1945, lindur dhe banues në Dhërmi, Himarë, Vlorë.

I paditur:

Stefo Bua, i biri i Spiro dhe Athina, datëlindje 1953, lindur dhe banues në Dhërmi, Himarë, Vlorë.

Objekti:

1. Konstatimi dhe deklarimi i pavlefshmërisë absolute (teresisht i pavlefshëm) të veprimit juridik testamentit nr.2 dt. 15.01.1986 dhe nr.12 repertori lëshuar nga Athina Buat trashëgimtarit Stefo Bua dhe thirrja në trashëgim e trashëgimtarëve ligjorë të të ndjerës Athina Bua për pasurinë e lënë nga ajo në këtë testament.
2. Pezullimi i çdo lloj transkacioni (shitje-blerje) të tokës së rregjistruar në emër të Stefo Bua, i cili rrjedh nga ky testament deri në përfundimin e gjykimit të çështjes.

Bazë ligjore:

Nenet 31, 32 e 202 vijues të K.P.Civile aktual neni 92 i K.Civil aktual, neneve 17 e 118 të Kodit Civil të vitit 1981, ligji mbi “Zyrat juridike pranë Gjkatave”, Ligji “Për Noterine” (Aktual i ndryshuar), nenet 46, 49.

LORÉ

Gjykata në përfundim të shqyrtimit të kërkesës për marrjen e masës së sigurimit të padisë në lidhje me pasurinë objekt material gjyki, Pala
se

- pasi çmoi ekzistencën e kushteve te vendosura në nenin 202 të Kodit të Procedurës Civile
- mori në konsideratë kriteret ne kompetencat e vlerësimit të Gjykatës të percaktuara me Vendimin Unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr. 10, datë 24.03.2004,
- dëgjoi pretendimet e palës paditëse në proces ne lidhje me këtë kërkim, në zbatim të së drejtës proceduriale që i njeh neni 203 dhe 205/6 i Kodit të Procedurës Civile, u shpreh në seancë pregaftore në lidhje me këtë kërkim dhe me konkretisht,

VËRËN SE:

I.Rrethanat e faktit.

Pala paditëse i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë me mjetin procedural, kërkesëpadi me objekt kërkimi dhe bazë ligjore sikurse është përcaktuar më sipër, duke thirrur si palë të paditur në këtë gjykim shtetasin Stefo Bua.

Paditësi pretendojnë se është trashëgimtar ligjor i Athina Bua. Një ndër trashëgimtarët ligjor të nënës së tij është edhe Stefo Bua, vëllai i tij. Paditësi është vendosur në dijeni se nëna e tij ka redekatuar një testament notarial datë 15.01.1986 me nr. 2 testamenti dhe nr. 12 repertori. Testamenti është redaktuar në Zyrën e Ndihmës Juridike. Pala paditëse pretendon se testamenti nuk përbën elementët e domsdoshëm për vlefshmërinë e tij.

-Testamenti nuk është nënshkruar nga testatorja.

-Në rastin kur testatorja nuk dinte shkrim dhe këndim sipas Kodit Civil të vitit 1981, Ligjt për Zyrat e ndihmës juridike, i cili përcaktonte rregulla të njëjtë sikurse edhe Ligji për Noterinë në fuqi aktualisht, testamenti duhet duhet të nënshkruhej nga një person i besuar në prezencë të noterit, por ky person i besuar duhet të identifikohej duke i përcaktuar numrin pasaportës dhe adresën e banimit. Në rastin konkret në përbajtje të testamentit nuk është shënuar që testatorja nuk di të shkruajë. Personi i bësuar nuk është identifikuar në përbajtje të testamentit, por vetëm në fund kjo e fundit ka hedhur nenshkrimin e myllur dhe jo emër dhe mbiemër me shkrimin e saj. Nga ana e noterit nuk është identifikuar gjithashtu lidhja e mundshme që mund të kishte ky person i besuar në raport me testatoren Athina Bua. Forma e testamentit është në kundërshtim me formën e kërkuar nga ligji material i kohës dhe kjo e bën atë të pavlefshëm.

Në mbështetje të pretendimeve të saj pala paditëse paraqiti në dobi të gjykit kopje të njesuar me origjinalin me vulën e kancelarit të Gjykatës të Fashikullit me nr. 683 vendimi, datë 09.05.2002. Në përbajtje të këtyre akteve rezultojë Vendimi nr. 683, datë 09.05.2002 i Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë me objekt lëshimin e dëshmisi së trashëgimisë së Athina Bua në favor të Stefo Bua, "Procesverbal çelje testamenti" nr. 1726 rep, nr. 638 kol, datë 22.04.2002, Testament nr. 12 rep, nr. 2 testamenti, datë 15.01.1986, Vendimi nr. 1073, datë 16.12.1987 me objekt pjesëtim pasurie, Çertifikatë personale të paditësit, datë lëshimi 15.04.2015.

Pala e paditur u njoftua nga ana e Gjykatës por nuk kishte konfirmim për marrje dijeni për seancën. Neni 205/2 i K.P.C. percakton se: "Sigurimi i padisë mund të lejohet për të gjithë padinë, ose vetëm për ato pjesë të saj, që gjykata i gjen të bazuara, në përputhje me rregullat e parashikuara në nenin 202 të këtij Kodi. Kërkesa, si rregull, shqyrtohet në prani të palëve, por në raste të veçanta ose të ngutshme, mund të shqyrtohet edhe pa u thirrur pala tjetër" Në rastin konkret Gjykata e ka zbauar dhe teikaluar kriterin procedural për mundësinë e vijimit të shqyrtimit të kërkesës për sigurimin e padisë edhe në mungesë të prezencës së palës së paditur, pasi ndërsa ligji lejon mos-thirrjen e palës së paditur, Gjykata ka procedura me thirrjen e palës së paditur, dhe në mungesë të konfirmimit të marjes dijeni përj saj gjëzon kompetencën për vijimin e shqyrtimit të kërkesës për shkak të natyrës së ngutshme të saj.

II. Legjislacioni i aplikueshëm. Praktika Gjyqësore e referuar.

Neni 202 i Kodit të Procedurës Civile:

"Me kërkesën e paditësit, gjykata brenda 5 ditëve lejon marrjen e masave për sigurimin e padisë, kur ka arsyet e dyshohet se ekzekutimi i vendimit për të drejtat e paditësit do të bëhet i pamundur ose i vështirë:

Sigurimi i padisë lejohet kur:

a) Padia mbështetet në prova me shkrese,

b) Paditësi jep garanci, në masën dhe në llojin e caktuar nga gjykata, për dëmin që mund t'i shkaktohet të paditurit nga sigurimi i padisë.

Garancia mund të kërkohet edhe për rastin e parashikuar nga shkronja "a" e këtij neni."

Neni 203 i Kodit të Procedurës Civile:

"Sigurimi i padisë lejohet për të gjitha llojet e padive dhe ne çdo fazë të gjykimit, deri sa vendimi të marrë formë të prerë. Sigurimi i padisë lejohet edhe nga Gjykata e Apelit, kur padia është duke u shqyrtuar prej saj.

Sigurimi i padisë nuk lejohet në rastet e padive që ngrihen gjatë fazës së ekzekutimit të vendimit, për të cilat zbatohet pjesa e katërt e këtij Kodi."

Neni 206/b të Kodit të Procedurës Civile:

"Sigurimi i padisë bëhet:

b) me anë të masave të tjera të përshtatshme të marra nga gjykata"

- Vendimi Unifikues nr. 10, datë 24.03.2004 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë

- Vendim nr. 22, datë 19.01.2011 i Kolegit Civil të Gjykatës së Lartë.

- Vendim nr. 479, datë 27.10.2011 i Kolegit Civil të Gjykatës së Lartë.

- Vendim nr. 227, datë 08.05.2012 i Kolegit Civil të Gjykatës së Lartë.

III. Vlerësimi i Gjykatës në lidhje me kërkesën për sigurimin e padisë.

Gjykata vlerëson bazueshmërinë në ligj të kërkesës për sigurimin e padisë, duke respektuar specifikat që paraqet shqyrtimi i një kërkese të tillë nga pikëpamja proceduriale ashtu edhe për sa i përket zgjidhjes së saj. Gjykata e vlerësoi kërkesën dhe objektin konkret të saj në përputhje me shpjegimet e palës paditëse si dhe me përcaktimet e Vendimit nr. 3/2012¹ të

¹ Objekti i padisë (petitum) është ajo që kërkohet nëpërmjet paraqitjes së kërkesëpadisë në gjykatë dhe, që ka të bëjë me vendimmarrjen që i kërkohet gjykatës. Neni 154 i K.Pr.Civile parashikon elementët e domosdoshëm që duhet të përbajë

Kolegeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në lidhje me përcaktimin e nocionit „objekt kërkimi“. Vlerësohet se kërkesa e parashtruar para këtij forumi gjyqësor gjen bazën e saj ligjore në nenin 202 dhe 206/b të K.P.C. Më konkretisht nenet 206/b dhe 202 të Kodit të Procedurës Civile parashikojnë se: „*Sigurimi i padisë bëhet: b) me anë të masave të tjera të lejon marrjen e masave për sigurimin e padisë, kur ka arsyé të dyshohet se ekzekutimi i vendimit për të drejtat e paditësit do të bëhet i pamundur ose i vështirë. Sigurimi i padisë llojin e caktuar nga Gjykata, për dëmin që mund t'i shkaktohet të paditurit nga sigurimi i padisë. Garancia mund të kërkohet edhe për rastin e parashikuar nga shkronja “a” e këtij nenit.*“ Parashikimi i realizuar në normat për sigurimin e padisë, nenet 202-212, evidenton premisat dhe kushtet për aplikimin e masës për ndalimin e veprimeve të mëtejshme pranë nga nëna e tij Athina Bua, konkretisht për pasurinë tokë. Nisur nga interpretimi logjik i nenit 202 të Kodit të Procedurës Civile, çmohet se për disponimin në lidhje me pezullimin e ekzekutimit gjykata duhet të ndalet në këto problematika ligjore dhe faktike:

- a) -Domosdoshmëria për marjen e masës së sigurimit.
- b) -Ekzistencë e kushteve për marjen e masës së sigurimit.
- c) -Përshtashmëria e llojit të masës së sigurimit të kërkuar nga pala paditëse.

Në kuadër të domosdoshmërisë për marrjen e masës së sigurimit gjykata konstatoi ekzistencën e dy premisave të përcaktuara nga neni 202 i K.P.C.-së:

- Identifikimi në mënyrë të qartë të një drejte subjektive
- Ekzistencë e një dyshimi të arsyeshëm të bazuar në prova shkresore të paraqitura nga pala kërkuese për pamundesinë apo vështirësinë në rivendosjen e të drejtës subjektive.

çdo kërkesëpadi. Në këtë nen përcaktohet se kërkesëpadia duhet të përbajë „përcaktimin e objektit të kërkesëpadisë“ dhe „kërkimin e paditësit“. Të dy këto formulime i referohen të njëjtës gjë, që është objekti i mosmarrëveshjes. Formulimi i ndryshëm nuk ndryshon kuptimin e tyre. Objekti i padisë dhe kërkimet e paditësit përbëjnë ato që quhen „pretendime vlerësuar objektin e padisë është e nevojshme të shihet kërkesëpadia në përbajtje të saj, të gjitha shtjellimet e kërkimet e paditësit dhe jo vetëm pjesa hyrëse e kërkesëpadisë. Natyrish që palët kanë detyrimin që të paragesin pretendime të qarta dhe të kuptueshme për palën tjetër dhe gjykaten, por jo domosdoshmërisht objekti i padisë gjendet gjithnjë vetëm në pjesën hyrëse të kërkesëpadisë (pavarësisht se në praktikë vërehet një konstante në këtë drejtim). Objekti i padisë përbledh në vetvëte të gjitha pretendimet e palës të parashtruara në aktin procedural të kërkesëpadisë. Ai mund të përbajë një kërkim ose disa të tillë, ndaj kur vlerësohet se çfarë padie është paraqitur për gjykim, gjykatat nuk duhet të kufizohen vetëm tek pjesa hyrëse e kërkesëpadisë, por duhet të shohin tërësinë e përbajtjes së saj. Kjo pasi zakonisht në pjesën hyrëse të kërkesëpadisë vendosen kërkimet bazë në formë të përbledhur. Një pjesë e kërkimeve të padisë gjendet në pjesës përshkruese dhe shpjeguese të saj, e një pjesë tjetër mund të gjendet në pjesën fundore të kërkesëpadisë. Referuar sa më sipër, Koleget e Bashkuara të Gjykatës së Lartë vlerësojnë se përgatitja dhe gjyktimi e zgjidha e çështjes nuk mund të bazohet vetëm mbi atë që formalisht shkruhet në pjesën hyrëse të kërkesëpadisë e që emërtohen „objekti i padisë“ dhe „baza ligjore“ e saj. Gjykata kur zgjidh mosmarrëveshjen merr në shqyrtim pretendimet e paditësit të cilat parashtrohen në kërkesëpadi si dhe gjatë ushtrimit të së drejtave që rrjedhin nga procesi, duke mbajtur parasysh se konform neneve 5, 31, 154 e 185 të K.Pr.C. objekti i padisë dhe shkaku i saj nuk përbldihen domosdoshmërisht vetëm në pjesën hyrëse të kërkesëpadisë. Gjykata ka detyrimin të vlerësojë dhe të marrë parasysh të gjithë përbajtjen e padisë dhe të identifikojë kërkimet e paditësit, në mënyrë që të mund të japë një vendim për to

Gjykata çmon se kjo mënyrë interpretimi është në përputhje ndër të tjera edhe me Jurisprudencën e Gjykatës së Lartë. Konkretisht në Vendimin nr. 479, datë 27.10.2011 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë është shprehur se:

"Ligjvënesi ka parashikuar sigurimin e padisë jo vetëm për të siguruar të drejtën, e cila përbën dhe tërësinë e kërkimeve të paditësit, por në të njëjtën kohë këtë parashikim e ka bërë dhe me qëllimin që të sigurojë efektivitetin dhe dobishmérinë e procesit gjyqësor që është duke u realizuar mes palëve. E drejta e paditësit për të kërkuar sigurimin e padisë është parashikuar shprehimisht në nenin 203 të K.Pr.Civile, në të cilin thuhet: "Sigurimi i padisë të lejohet për të qjitha llojet e padive dhe në çdo fazë të gjykimit, derisa vendimi të marrë formë prerë. Sigurimi i padisë lejohet nga gjykata e apelit, kur padia është duke u shqyrtuar prej saj".

Në nenin 206 të K.Pr.Civile, "Llojet e masave për sigurimin e padisë", parashikohet se: "Sigurimi i padisë bëhet: a) me sekuestrimin e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme, si dhe të kredive të debitorit; b) me marrjen nga ana e gjykatës të masave të tjera të përshtatshme, duke përfshirë edhe pezullimin e ekzekutimit...".

Në referencë dhe në interpretim të dispozitave të mësipërme, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë vlerëson se në gjykime të këtij lloji (sigurimin e padisë), në mënyrë që gjykata të vendosë për marrjen e një mase sigurimi padie (të parashikuara këtë të fundit në nenin 206 të K.Pr.Civile), duhet të hetojë ekzistencën e dy kushteve themelore:

a) Ekzistenca e mundshme e një të drejtë për të cilën kërkohet mbrojtje gjatë procesit të gjykimit të padisë;

b) Ekzistenca e frikës që ekzekutimi i vendimit për të drejtën që kërkohet të mbrohet do të bëhet i pamundur ose i vështirë."

Të njëtin qëndrim mban Gjykata e Lartë mban në Vendimin nr. 22, datë 19.01.2011 i Kolegjit Civil: "Gjykimi për marrjen e masës për sigurimin e padisë është një proces i shpejtë, ku gjykata nuk shqyrton dhe vlerëson të qjitha provat në mënyrë të hollësishme për të parë nëse qëndrojnë apo jo pretendimet e kërkuesit, nëse qëndron apo jo e drejta.

Në gjykime të këtij lloji, gjykata vetëm heton nëse plotësohen këto kushte: (a) ekzistenca e mundshme e një të drejte për të cilën kërkohet mbrojtje në procesin e gjykimit të padisë, dhe (b) ekzistenca e frikës, që ekzekutimi i vendimit për të drejtën që kërkohet të mbrohet do të bëhet i pamundur ose i vështirë.....Qëllimi i marrjes së masës për sigurimin e padisë referuar si legjislacionit shqiptar, por dhe legjislacionit ndërkombëtar është: (i) jo vetëm sigurimi i së drejtës, e cila përbën dhe tërësinë e kërkimeve që do të parashtrojë paditësi në padinë e tij, (ii) por në të njëjtën kohë dhe ajo që është më e rëndësishmja, është që të sigurojë efektivitetin mënyrë që kjo e drejtë të cilën paditësi kërkon të realizojë dhe të njoftë nëpërmjet një procesi vendimi përfundimtar të mos mbetet i paekzekutueshëm, dhe që

Në vijimësi të kësaj logjike gjykata hetoi në lidhje me ekzistencën e dy kushteve themelore:

-Identifikimi në mënyrë të qartë të një drejte subjektive të paditëses, e tillë që të preket nga disponimi i vendimit përfundimtar për procesin gjyqësor.

Qëllimi i një parashikimi të tillë nënkupton marrjen në mbrojtje apo *sigurimin e ekzekutueshmërisë* së një të drejte subjektive, e cila "de jure" merret në mbrojtje nga e

Kjo

drejta pozitive, i krijohet akses gjetjes së një zgjidhje gjyqësore të saj në rast të shkeljes, cenimit apo mohimit të saj, duke i bashkëlidhur këtyre modalitetave edhe elementin e fundit dhe më të rëndësishëm, që mundëson vënien në jetë "de facto" të saj, duke konceptuar me këtë të fundit jo vetëm inicimin realisht të procesit të ekzekutimit të detyrueshëm, por edhe *paraprirjes* në kohë *ndaj pamundësisë apo vështirësisë* së *ekzekutimit* të së *drejtës subjektive, përmes masës për sigurimin e padisë*. Duke marrë në konsideratë kërkimet e parashtruara dhe natyrën e padisë që kërkohet të sigurohet, rezulton se përmes këtij mjeti procedural paditësi synon të mbrojë të drejta të natyrës pasurore, reale, të drejta të cilat lidhen me pasuri së paluajtshme dhe që pretendon ti ketë fituar me trashëgimi ligjore nga nëna e tij. Këtë kërkesëpadi paditësi e parashtron pasi identifikon një situatë fakti e cila i kundërvihet dhe e cënon të drejtën e tij të pronësisë të fituar me trashëgimi.

Duke qënëse paditësi identifikoi si pamundësi apo vështirësi të vënies në jetë të së drejtës së tij të pretenduar në padi, pikërisht mundësinë e tjetërsimit të pasurisë apo realizimit të formave të tjera disponimit ndaj saj nga i padituri, për sa kjo e fundit pretendohet që të fitohet nga pala paditëse në cilësinë e bashkëpronarit përmes gjykimit të inicuar, duke deklaruar të pavlefshëm testamentin. Në rast eventual të ndodhjes së një rrethane të tillë si pranimi i padisë dhe njohja e^r paditësit në cilësinë e bashkëpronarit të pasurisë, atëherë vënia në disponim e kësaj pasurie nga paditësi do të vështirësohej apo të do të ishte e pamundur nëse sendet e paluajtshme të përfshira nga trashëgimia ndërkohë do të jenë tjetërsuar në të tretë nga i padituri. Pala paditëse e shtriu pretendimin e saj për marjen e masës së sigurimit të padisë mbi një lloj specifik pasurie të paluajtshme, konkretisht „tokë“ e rregjistruar në emër të Stefo Bua pranë ZVRPP Vlorë dhe që si burim të saj ka tetstamentin objekt kundërshtimi me pavlefshmëri. Në identifikimin e këtij rreziku tjetrësimi pala paditëse identifikoi faktin se kjo e fundit është në dijeni të tjetërsimeve të pasurive të tjera që i padituri ka përfshuar nga trashëgimia e nënës së tij.

➤ Ekzistenca e kushteve mbi disponimin për vendosjen e masës së sigurimit.

Paraqitura e provave shkresore në mbështetje të kërkesëpadisë.

Teresia e akteve shkresore të paraqitura plotëson kriterin e tretë të kërkuar nga neni 202/a të Kodit të Procedurës Civile, mbështetjen e padisë në prova shkresore.

Provat e paraqitura janë në formën e kërkuar nga neni 202, konkretisht prova shkresore, akte të cilat nga pikëpamja formale, duke përjashtuar në cdo rast aspektin substancial, plotësojnë të gjitha kriteret e përcaktuara nga Kodi i Procedurës Civile mbi marrjen e tyre (njehsimi i tyre me originalin, ekzistenca e të gjitha elementeve të përbajtjes së jashtme të dokumentit, vula, data, mospatja e fshirjeve, mbishkrimeve etj.) Në rastin objekt gjykimi gjykata vlerëson vetëm faktin se aktet shkresore mbi të cilat mbështeten pretendimet e kërkueses, plotësojnë kriteret e përcaktuara në rregullat e përgjithshme për marrjen e provave sipas dipozitave të posaçme proceduriale mbi aktet zyrtare apo shkresat private, por pa i hyrë konkretisht fugisë së tyre provuese.

- Balanca e duhur në mbrojtjen e interesave të palëve ndërgjyqëse.

Kjo do të nënkuptojoj se pavarësisht qëllimit, që evidenton ligjvënësi përmes nenit 202 të K.P.C., (mbrojtja e interesit të paditësit), duhet të vlerësohet dhe të merret në konsideratë në raport krahasues edhe *dëmi i mundshëm* që pëson pala e paditur. Kjo shtrohet gjithmonë në raport me llojin e masës së sigurimit të caktuar nga gjykata.

Gjykata e Lartë në prakikën e saj, konkretisht *Vendim i Kolegit Civil të Gjykatës së Lartë nr. 227, datë 08.05.2012* ka mbajtur qëndrimin se: "Nga Vendimi Unifikues i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë del qartë se përvendosjen e masës së sigurimit të padisë sipas germës a të nenit 202/2 të K.Pr.C., gjykata duhet të ketë parasysh që të plotësohen dy kushte njëherësh, të cilët janë: pala kërkuese të ketë paraqitur prova shkresore dhe të ketë dyshime se ekzekutimi i vendimit bëhet i pamundur, ose i vështirë,....Kolegji Civil e vlerëson se në rastin kur ka prava me shkresë nuk është e detyrueshme që të vendoset garancia bankare, por është në vlerësim të gjykatës nëse duhet vendosur ose jo kjo garanci."

Gjykata nisur nga natyra e kërkimit dhe tërësia e rrëthanave të mësipërme ligjore dhe faktike vlerëson se garancia nuk është kriter i domosdoshëm në rastin objekt gjykimi për lejimin e sigurimit të padisë. Ky konstatim rezulton mbështetur në këto faktorë:

Së pari, nga interpretimi gramatikor i shprehjes "garancia mund të kërkohet edhe përvastin e parashikuar nga shkronja "a" e këtij nen", gjykata arrin në përfundimin se përvastët pranuar kërkessën përsigurimin e padisë nuk duhet të plotësohen domosdoshmërisht në mënyrë kumulative kushtet e parashikuara në pikën "a" dhe "b" të Kodit të Procedurës Civile.

Së dyti, në zbatim të kufijve që përcakton Vendimi Unifikues i Gjykatës së Lartë nr. 10, datë 24.03.2004, rezulton se masa e pezullimit të veprimeve vetëm si rregull duhet të shoqërohet nga garancia pasurore, duke mos përashtuar ky lloj përcaktimi, në interpretim edhe të praktikës së sipërcituar të Kolegit të Gjykatës së Lartë, rastet kur gjykata çmon se garancia pasurore nuk përbën kusht të domosdoshëm sipas specifikave të çështjes konkrete.

Së terti, në rastin konkret objekt gjykimi, konstatohet se në raport me perfundimet e mundshme në të cilat mund të rezultojë procesi gjyqësor dhe me pasojat që do të vinin nga mos-sigurimi i padisë, këto të fundit do të rezultonin më të mëdha dhe të parikuperushme, sikurse u analizuan më sipër. Ndërsa tjetër rast, gjykata e kufizuar masën vetëm ndaj pasurisë që Stefo Bua ka të ketë të rregjistruar në ZVRPP Vlorë cilësinë e pronarit dhe që është përfstuar si pasojë e Testamentit nr. 2 test, nr. 12 rep, datë 15.01.1986 dhe Dëshmisi së Trashëgimisë lëshuar për këtë testament, konkretisht Vendimi nr. 683, datë 09.02.2002 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe më spëcifikisht vetëm përvastinë "Tokë".

Plotësohet edhe kushti tjetër, se masa e sigurimit të padisë dallon thelbësishët nga detyrimi apo e drejta objekt kërkimi me themelin e padisë që pretendohet të përfshohet përmes zgjidhjes përfundimtare të çështjes përmes një vendimi gjyqësor përfundimtar të formës së prerë për këtë lloj gjykimi. Ndërsa masa e sigurimit të padisë synon ne mbajtjen pezull të veprimeve pranë ZVRPP Vlorë në lidhje me pasurinë e paluajtshme, padia synon në njohjen pronar të paditësit mbi këtë pasuri.

Si konkluzion, rezulton se:

- Plotësohen në mënyrë kumulative elementët e mësipërm, kritere ligjore të domosdoshme për lejimin e sigurimit të padisë, konkretisht ekzistencë e një drejtë subjektive, ekzistencë e një dyshimi të arsyeshëm të bazuar në prova mbi pamundësinë ose vështirësinë e vënies në jetë të së drejtës subjektive si dhe mbështetja e kërkesës në prova shkresore, duke përjashtuar prova të llojeve të tjera nga ato që parashikon K.P.Civile.
- Lloji i mases së sigurimit është proporcional dhe ruan balancën e interesave mes palëve ndërgjyqëse..

Në analizë të të gjithë elementëve ligjore të mësipërm si dhe bazuar në provat e paraqitura nga palët ndërgjyqëse, gjykata vlerëson se kërkesa për sigurimin e padisë duhet të pranohet:

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata bazuar në nenin 125, 158/a, 202-212 të Kodit të Procedurës Civile, Vendimin Unifikues nr. 10, datë 24.03.2004 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, Vendimit të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr. 227, datë 08.05.2012, Vendimit nr.479, datë 27.10.2011 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, Vendim nr. 22, datë 19.01.2011 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë,

VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës.
2. Sigurimin e padisë duke urdhëruar pezullimin e çdo lloj veprimi mbi pasurinë trashëgimore të paluajtshme të llojit "Tokë" të rregjistruar në emër të Stefo Bua, i biri i Spiro, datëlindje 13.06.1953 dhe që ka burim fitimi pronësie Testamentin nr. 12 rep. Nr. 2 testamenti, datë 15.01.1986 realizuar para Zyrës së Ndihmës Juridike, për të cilin është lëshuar Dëshmja e Trashëgimisë me Vendimin nr. 683, datë 09.05.2002 të Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë.
3. Ky vendim përbën titull ekzekutiv.
4. Ngarkohet Shërbimi përmbarimore shtetëror ose privat për ekzekutimin e këtij titulli.
5. Një kopje e këtij vendimi i përcillet Zyrës Vendore të Rregjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë.
6. Kunder këtij vendimi lejohet ankim i veçantë ne Gjykaten e Apelit Vlorë brenda 5 diteve, duke filluar ky afat nga dita e neserme e shpaljes se ketij vendimi për palën paditëse prezent dhe nga dita e nesërme e marrjes dijeni për vendimin nga pala e paditur në mungesë.
7. U shpall në Vlorë, me datë 04.06.2015.

SEKRETARE
REZARTA LAZAJ



GJYQTARE
ELONA MIHALI